

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-091/13

Prishtinë,

17 janar 2014

Në çështjen juridike të

M. L.

Mal i Zi-Bar

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

kundër

E panjohur

Kolegji i Apelit i AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva- Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/167/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA91326), i datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 janar 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Hedhet si e pasafatshme ankesa e M. L. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/167/2012 për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA91326, të datës 5 shtator 2012.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 27 nëntor 2006, M. L. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) ku ka kërkuar të drejtën e pronës në ngastrat kadastrale të tij 691/2, 691/2,691/3 dhe 745/5 në Komunën e Istogut, zona kadastrale e Luboves me numër kadastral 70806030 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2 hektarë 62 ari e 69 m². Në kërkesë ishte cekur se uzurpuesi ishte i panjohur.
2. Më 13 gusht 2010, Lalić ka theksuar se KKPK-ja si ia kishte shitur pronën bartësit aktual të së drejtës pronësore, A. K. nga Peja. Ai gjithashtu ka deklaruar K. nuk e kishte paguar çmimin e plotë të blerjes.
3. Më 5 shtator 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës ka hedhur poshtë kërkesën me vendimin grupor KPCC/D/R/167/2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA91326. Në paragrafin 54 dhe 55 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të certifikuar të datës 1 shkurt 2013 vlen posaçërisht për këtë kërkesë, theksohet se paraqitësit e kërkesës (në këtë rast L) e kishte njoftuar Sekretarinë Ekzekutive se pronat i ishin shitur një pale të tretë pas konfliktit në bazë të një kontrate të vlefshme të shitblerjes. Në këtë mënyrë KKPK-ja ka vërtetuar se L. nuk e kishte humbur posedimin e pronës si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999, por si rezultat i transaksionit të shitblerjes vullnetare pas konfliktit. Rrjedhimisht, kërkesa ishte jashtë juridiksionit të Komisionit dhe ishte hedhur poshtë.
4. Kërkesa e L. nuk i ishte dorëzuar K. dhe K. nuk është përgjigjur në kërkesë.
5. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar L. më 11 mars 2013. Ai e ka kundërshtuar vendimin me 12 prill 2013. Gjykata Supreme e ka pranuar lëndën më 21 tetor 2013. Ankesa nuk i është dorëzuar A. K.

Pretendimet e palës ankuese

6. M. L. pohon me ankesën e tij ia kishte shitur pronën A. K. nga Peja. Megjithatë K. nuk i ishte përmbajtur marrëveshjes pasi që ai nuk e kishte paguar këstin e fundit prej 15 000 euro. Afati për

pagesë kishte skaduar më 31 dhjetor 2004. Prandaj, K.nuk është bërë pronar i pronës së kërkuar. L. pretendon se K. se ka vepruar në keqbesim si dhe në transaksionet tjera në dëm të personave tjerë të zhvendosur nga Kosova.

Arsyetimi ligjor

7. Ankesa është papranueshme pasi që ajo nuk është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh të parashikuar me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Afati për paraqitje të ankesës ishte 10 prilli 2013, ndërsa ankesa është paraqitur nga Lalić më 12 prill 2013. Gjykata Supreme veq ka vendosur në një lëndë të njejtë siç është lënda GSK-KPA-A-29-33/12, në të cilën ankesa është ushtruar dy ditë pas afatit.
8. Duke marrë parasysh faktin se ankesa është pa-afatshme, Gjykata Supreme e konsideron si të panevojshme që ankesa t'i dorëzohet A. K. me qëllim të dëgjimit pikëpamjeve të tij rreth kësaj kësaj lënde.
9. KKPK-ja dhe Gjykata Supreme nuk ka vendosur për bazueshmërinë e kësaj çështje juridike. Ky kontest eventualisht mund të zgjidhet nga gjykatat kompetente të Kosovës.
10. Në të mësipërmen, sipas dispozitës së nenit 196 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këshilla Ligjore

11. Sipas dispozitave të nenit 13.6 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është përfundimtar dhe num mund të kundërshtohet me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it